



Datë: 14.07.2025
Numër Protokolli: 4789/2025

A.nr.864/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar, Ardita Haxhnikaj–Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Rushit Kajtazi- në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.864/2025, të datës 12.05.2025, të parashtruar nga ankuesi B.K, kundër organit të punësimit: Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 14.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.864/2025, e datës 12.05.2025, e parashtruar nga ankuesi B.K.

II. Mbetet në fuqi, Njoftimi i datës 05.05.2025, lidhur me përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit të suksesshëm për pozitën “Zyrtar për Vlerësim të Gjendjes së Mbeturinave Kimikateve dhe Materieve të Rrezikshme, i Divizionit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë.

A r s y e t i m

Ankuesi B.K (me tej referuar vetëm ankuesi), më datë 12.05.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr.864/2025, lidhur konkursin me numër referencës RN0001 6376, për Grupin i Përgjithshëm i Mjedisit, për pozitë, Zyrtar për Vlerësim të Gjendjes së Mbeturinave Kimikateve dhe Materieve të Rrezikshme, me pretendimet ankimore se kam aplikuar brenda afatit kohor, sipas konkursit duke i ofruar të gjitha dokumentet e kërkuara dhe se vlerësoj se i plotësoj të gjitha kriteret e përgjithshëm dhe të veçanta të konkursit dhe se i kam kaluar të gjitha fazat e verifikimit dhe vlerësimit por konsideroj se me është bërë padrejtësi me mohimin e të drejtës të jem kandidatë fitues për pozitën e shpallur, dhe në testim me shkrim kam arritur gjithsejtë 61, pikë, ndërsa kandidati fitues është vlerësuar me gjithsejtë 56.6, gjë që dëshmohet se epërsitë e mija, në ofrimin e njohurive në testim me shkrim kundër kandidatit nuk mund të injorohen dhe duhet të kihen parasysh dhe së në intervistë jam vlerësuar me gjithsejtë, me 20, pikë nga 30, gjithsejtë kurse kandidati fitues është vlerësuar me 28.4, pikë përkundër faktit që jam përgjigjur në të gjitha pyetjet dhe se kjo me bënë të hedh dyshime dhe pretendimet e mija për një proces tërësisht të manipuluar nga ana e Komisionit të Vlerësimit, me tej ankuesi ka pretenduar që të aprovohet ankesa si e bazuar duke anuluar njoftimin e datës

05.05.2025, lidhur me kandidatin fitues, dhe ti jepet e drejta ankuesit për të qenë fitues për pozitën e shpallur.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 19.05.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, ndërsa kjo e fundit, më datë 27.05.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Tutje, Kryetari i Këshillit, me vendim me numër protokolli 4289/2025, të datës 23.06.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr. 864/2025, të parashtruar nga ankuesit edhe për dhjetë (10) ditë pune, lidhur me ankesën e ankuesi B.K.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova: Ankesën A.Nr. 3097/2025 të datës 12.05.2025, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e letërnjoftimit për ankuesin; Njoftimi i datës 05.05.2025, për përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit të suksesshëm, i nxjerr nga Divizioni i Burimeve Njerëzore MMPHI-së; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 19.05.2025, dërguar përmes emailit, nga R.K për H.K; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 864/2025, e datës 27.05.2025; Emalin e datës 05.05.2025, dërguar nga Zyra e Personelit e MMPHI-së; Renditjen përfundimtarë të kandidatëve të datës 05.05.2025; Pyetje të intervistës me gojë; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 18.04.2025, për kandidatin A.Z, nga anëtari i komisionit A.H; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 18.04.2025, për kandidatin A.Z, nga anëtari i komisionit F.I; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 18.04.2025, për kandidatin A.Z, nga anëtari i komisionit P.G; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 18.04.2025, për kandidatin A.Z, nga anëtari i komisionit A.M; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 18.04.2025, për kandidatin A.Z, nga anëtari i komisionit T.V; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 18.04.2025, për kandidatin B.K, nga anëtari i komisionit A.A; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 18.04.2025, për kandidatin B.K, nga anëtari i komisionit F.I; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 18.04.2025, për kandidatin B.K, nga anëtari i komisionit P.G; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 18.04.2025, për kandidatin B.K, nga anëtari i komisionit A. M; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 18.04.2025, për kandidatin B.K, nga anëtari i komisionit T.V; Njoftimi i datës 07.04.2025, i Divizionit për Burime Njerëzore i MMMPH- së; Testi me shkrim, pjesa e parë; ; Formulari për Vlerësimin të Përgjithshëm të Ecëses së Kandidatit nga Komisioni i Pranimit, i datës 07.04.2025, sipas kodit CN6155; Formulari për Vlerësimin të Përgjithshëm të Ecëses së Kandidatit nga Komisioni i Pranimit, i datës 07.04.2025, sipas kodit CN4065; Testi me shkrim fleta 1 dhe 2; Testi me shkrim i kandidatit të përzgjedhur A.Z; Testi me shkrim i ankuesit; Emali i datës 28.03.2025, dërguar nga Zyra e personelit; Vendimi me numër protokolli 1765, i datës 24.03.2025, për themelimin e komisionit të pranimit i nxjerr nga Drejtori Ekzekutiv i AMMK-së; Vendimi me numër protokolli 6653, i datës 03.11.2022, për T.V; Akt Emërimi i datës 01.07.2015, për T.V; Vendimi me numër protokolli 7066, i datës 01.12.2023, për P.G; Ndryshimi dhe Plotësimi i Akt Emërimit i datës 20.06.2018, për P.G; Akt Emërimi i datës 02.08.2024, për A.A; Akt Emërimi i datës 19.05.2014, për F.I; Akt Emërimi i datës 06.06.2025, për A.M; Lista e aplikantëve; Ri- njoftim i datës 25.03.2025; Njoftimi i datës 24.03.2025; Njoftimi i datës 20.03.2025; Vendimi me numër

protokolli 1328/25, i datës 06.03.2025, për shtyrje të afatit i nxjerr nga Divizioni i Burimeve Njerëzore i MMPHI-së; Konkursi me numër referencë RN00016376, i datës 20.01.2025; Aplikacioni i B.K, me shkresat e bashkangjitura; Diplomë me numër protokolli 1554, e datës 17.10.2014 , për B.K, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”; Diplomë me numër protokolli 918, e datës 09.01.2019 , për B.K, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”; vërtetim i datës 10.09.2024, për B.K; Letër referencë e datës 20.05.2024, për B.K; Kontrata e punës e datës 13.11.2024, për B.K; Kopje e letërnjoftimit për B.K; Deklaratë e B.K, e datës 09.09.2024; Certifikatë e datës 22.01.2019; Pasqyra e trustit për periudhën nga data 01.09.2012, deri me datën 09.09.2024, për B.K; Aplikacioni i A.Z, me shkresat e bashkangjitura; Diplomë me numër protokolli 1210, e datës 19.09.2024 , për A.Z, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”; Diplomë me numër protokolli 3647, e datës 06.01.2022 , për A.Z, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”; Certifikatë e datës 28.01.2016, për A.Z; Veremit i datës 14.06.2022; Referencë e datës 14.01.2022, për B.K; Referencë e datës 27.05.2022, për B.K; Marrëveshje për punë Praktike, e datës 03.04.2023; Marrëveshje për punë Praktike, e datës 03.10.2023; Kontratë për kryerjen e punës praktike profesionale e datës 10.05.2024; Akt Emërimi i datës 01.08.2024, për A.Z; Letër rekomandim e datës 25.10.2024; Kopje e letërnjoftimit për A.Z; Vetë deklaratë e datës 24.10.2024; Vërtetim i datës 02.04.2024; Referencë e datës 04.04.2024; Pasqyra e trustit për periudhën nga data 01.08.2022, deri me datën 14.02.2025, për A.Z.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankueses, është e pabazuar, sepse:

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës më datë 20.01.2025 ka shpallur konkursin me numër të referencës RN00016376, për Grupin i Përgjithshëm i Mjedisit”, për pozitën ” Zyrtar për Vlerësim të Gjendjes së Mbeturinave Kimikateve dhe Materieve të Rrezikshme, Agjencinë për Mbrojtën e Mjedisit të Kosovës, numri i kërkuar një (1) pozitë, Profesional 2 me afat aplikimi nga data 21.01.2025 deri me datë 19.02.2025.

Tutje, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me datë 05.05.2025, ka publikuar njoftimin lidhur me kandidatin fitues, nga i cili njoftim rezulton se kandidatja A.Z, është vlerësuar me gjithsejtë 85, pikë ndërsa ankuesi është vlerësuar me gjithsejtë 81, pikë.

Ankuesi B.K, i pakënaqur me procedurën e rekrutimit, me datë 12.05.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet sikur janë përmendur në hyrje të këtij arsyetimi.

Në kuptim të dispozitave të nenit 89 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe në kontest të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ka analizuar konkursin me numër të referencës RN00016376 për Grup i Përgjithshëm i Mjedisit”, për pozitën ” Zyrtar për Vlerësim të Gjendjes së Mbeturinave Kimikateve dhe Materieve të Rrezikshme, Agjencinë për Mbrojtën e Mjedisit të Kosovës, numri i kërkuar një (1) pozita, Profesional 2, dhe konstatoi se si kritere të përgjithshme formale për pozitën përkatëse të punës kanë qenë:

Arsimi i kërkuar: Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) në fushat; Inxhinieri Mjedisit Mjedisit/ Kimi e Përgjithshëm, Biologji, Ekologji, Gjeografi;

Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 1 (1) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se kriteret e konkursit për pozitën Grupin i Përgjithshëm i Mjedisit”, për pozitën ”Zyrtar për Vlerësim të Gjendjes së Mbeturinave Kimikateve dhe Materieve të Rrezikshme, Agjencinë për Mbrojtën e Mjedisit të Kosovës,’, numri i kërkuar një (1) pozitë, Profesional 2 “, kanë qenë në pajtim me Rregulloren (QRK) nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, si dhe në pajtim me Katalogun e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil të Kosovës.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit nga shqyrtimi i provave materiale të kësaj çështje ka gjetur se Komisioni i Pranimit, i themeluar sipas vendimit me numër protokolli 1765/25 , të datës 24.03.2025, të nxjerr nga Z.V, Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë për Mbrojtën e Mjedisit të Kosovës, përgjegjës për vlerësimin profesional të kandidatëve në këtë procedurë të rekrutimit, ka qenë komisioni në këtë përbërje: z. T.V, Kryesues i Komisionit, i cili sipas Akt emërimit të datës 01.07.2015 , mbanë pozitën e punës “ Udhëheqës i Sektorit, z. P.G, i cili sipas Akt emërimit të datës 20.06.2018 , mbanë pozitën e punës “Udhëheqës i Sektorit për sistemim e informimit Mjedisor”, z. A.A, i cili sipas Akt emërimit të datës 02.08.2024, mbanë pozitën e punës” Drejtor i Drejtorisë të Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës, z. F.I, e cila sipas Akt emërimit të datës 15.04.2014 mbanë pozitën e punës “ Zyrtare e Lartë e Personelit”; z. A.M. i cili sipas Akt emërimit të datës 06.06.2015, mbanë pozitën e punës “ Zyrtar për Cilësi të ajrit dhe të zhurmës”. Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit konstaton se komisioni i pranimit, ka qenë në përputhje me nenin 40, paragrafi 1,2, nen paragrafi 2.1,2.2,2.3 Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku thuhet se: 1. Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve për pranim në shërbim civil në pozitë të kategorisë profesionale bëhet nga komisioni i pranimit. 2. Komisioni i pranimit ka pesë (5) anëtare/ë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunës/ës civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas grupit për të cilin zhvillohet konkurrimi; 2.2. një (1) përfaqësues/ës nga njësia përgjegjëse; dhe 2.3. një (1) nëpunës/ës i kategorisë profesionale të fushës përkatëse për kategorinë profesionale, si dhe nenit 20, paragrafi 1, 2, nen paragrafi 2.1,1.2 dhe 2.3 të Rregullores (QRK) NR. 15/2023 Për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se;1. Komisioni i pranimit për vlerësimin profesional të kandidateve për pranim në shërbim civil në pozitë të kategorisë profesionale themelohet me vendim të Zyrtarit Kryesor Administrativ të institucionit që zhvillon procedurën e rekrutimit për institucionet e administratës shtetërore. Komisioni i pranimit në institucionin tjetër themelohet me vendim të titullarit të institucionit. 2. Komisioni i pranimit ka pesë (5) anëtarë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunës civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas pozitës për të cilin zhvillohet konkurrimi; 2.2. një (1) përfaqësues nga NjMBNj; dhe 2.3. një (1) nëpunës i kategorisë profesionale i fushës përkatëse.

Thënë me tepër, Kolegji për vendosje të drejtë dhe meritore iu referua nenit 39 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, më të cilin është përcaktuar se: Procedura e pranimit në Shërbimin Civil 1. Pranimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj. 2. Rekrutimi për kategorinë profesionale organizohet për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe pozitë apo grup pozitash të administrimit të veçantë, sipas nevojës së institucionit dhe sipas planifikimit të NjMBNj-së. 3. Rekrutimi për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë organizohet nga njësia përgjegjëse. 4. Përrjashtimisht përcaktimeve të këtij ligji, për institucionet që kanë nëpunës/e civil me status të veçantë, procedurat e rekrutimit i zhvillon NjMBNj e atij institucioni. 5. Shpallja e procedurës së rekrutimit për pozitë apo grup pozitash të

administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë, bëhet nga njësia përgjegjëse në SIMBNj-së, si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit. 6. Pranimit i aplikacioneve bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e shpalljes së procedurës së rekrutimit. 7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 8. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimit i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi. Vlerësimi profesional i kandidatëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë. 10. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është njëqind (100) pikë. 11. Në përfundim të vlerësimit, kandidatja/i fitues konsiderohet kandidatja/i i vlerësuar me më së shumti pikë, por jo më pak se shtatëdhjetë për qind (70 %) të pikëve totale të vlerësimit. Të gjithë kandidatet/ët njoftohen individualisht me rezultatet e procesit të rekrutimit. Lista e kandidateve/ëve që kanë kaluar pragun prej shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve totale publikohet në SIMBNj-së, si dhe në ueb faqen e institucionit përkatës.

Referuar kuadrit ligjor si me lart Kolegji i Këshillit ka shqyrtuar dosjen e kandidates A.Z të shpallur fitues dhe si rrjedhojë ka gjetur se e njëjti posedon Diplomë universitare numër protokolli 3647, të datës 06.01.2022, sipas së cilës ka përfunduar studimet themelore Bachelor i Ekologjisë dhe Mbrojtës së Ambientit, si dhe diplomës universitare numër protokolli 1210, të datës 19.09.2024, sipas së cilës ka përfunduar studimet Master i Shkencave të Biologjisë, me përvojë punë sipas vërtetimit, të datës 14.06.2022, të lëshuar nga N.T.SH "Bleri -Al- Plast, me çka dëshmohet së nga data 02.03.2020 deri me datën 31.05.2022, ka mbajtur pozitën " Zyrtare për Çështje Administrative dhe Mjedisore", sipas marrëveshjes për punë praktike të datës 03.04.2023, e lëshuar nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nga data 03.04.2023, deri me datën 01.10.2023, ka mbajtur pozitën "Praktikantë", sipas marrëveshjes për punë praktike të datës 03.10.2023, e lëshuar nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës nga data 03.10.2023, deri me datën 02.04.2024, ka mbajtur pozitën "Praktikantë", sipas Kontratës me numër protokolli 1/142, të datës 10.05.2024, e lidhur me Universitetin e Prishtinës " Hasan Prishtina", nga data 15.04.2024, deri me datën 14.04.2025, ka mbajtur pozitën "Praktikantë", ndërsa sipas Akt Emërimit me numer protokolli Nr. 13-11/01-01-0050201/2024, të datës 01.08.2024, të lëshuar nga Komuna e Podujevës, nga data 01.08.2024, mbanë pozitën "Zyrtare për Mbrojtje e Mjedisit".

Kolegji i Këshillit me qëllim të sqarimit të nënshkrimit të formularve të Vlerësimit të Përgjithshëm të esesë së kandidatit nga Komisioni i Pranimit, ku përmes këtij formulari anëtarët e Komisionit, z, B.K, z.F.B dhe znj.M.M, kanë nënshkruar formularët e esesë, ndërsa në intervistë me gojë pyetjet i kanë parashtruar T.V, P.G , A.A dhe A.M, ka kërkuar sqarim shtesë nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ndërsa Zyrtarja e Lartë e Personelit e Ministrisë Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me datë 08.07.2025, përmes emailit ka dërguar sqarime ku përmes këtij emaili ka konstatuar së për shkak të mungesës se disa prej anëtarëve të Komisionit në datën e mbajtjes së testimit me shkrim me datë 02.04.2025, në vend të tyre kanë marrë pjesë zëvendësuesit e tyre, z.B.K, e ka zëvendësuar z.T.V, sepse ky i fundit ka qenë në udhëtim zyrtar, z.F.B, e ka zëvendësuar z.A.A, sepse ky i fundit ka qenë në udhëtim zyrtar dhe znj.M.M, e ka zëvendësuar z.A.M, sepse kjo i fundit ka qenë në udhëtim zyrtar, ndërsa në intervistë kanë marr pjesë anëtarët e rregullt të Komisionit, ky ndryshim është i paraparë në kuadrin ligjor në rastin e mungesës së anëtarëve dhe është sqaruar nga Kolegji **ex officio** me qëllim të sqarimit të çdo paqartësie.

Andaj, bazuar në rrethanat dhe konstatimet si me sipër, Kolegji i Këshillit konstaton se Divizioni i Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinore dhe Infrastrukturës, me rastin e shpalljes së Njoftimit të datës 05.05.2025 për Renditjen përfundimtare të kandidatit për pozitën e punës ‘‘Zyrtar për Vlerësim të Gjendjes së Mbeturinave Kimikateve dhe Materieve të Rrezikshme, sipas konkursit me numër reference RN00016376, ka zbatuar drejtë ligjin material, duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, si dhe Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kështu që për sa me sipër dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr. 864/2025

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit B.K;
- Divizionit për Burime Njerëzore në Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së